



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Monitorimi i Investimeve Kapitale të N.H “Ibër-Lepenc” sh.a Prishtinë – Viti 2022

Zbatimi i listës së projekteve të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit
tarifor 2022-2024 për vitin 2022

Prishtinë, gusht 2023

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Investimet e aprovuara për N.H “Ibër Lepenc”	4
3. Monitorimi i listës së investimeve kapitale.....	5
4. Projekti i Bankës botërore	6
5. Konkluzione.....	6
6. Rekomandime	7

1. Hyrje

Me qëllim të monitorimit të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, ARRU, komfor mandatit ligjor, ka realizuar takim në N.H “Ibër Lepenc”, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2022.

Takimi është mbajtur në zyrat e N.H “Ibër-Lepenc” me përfaqësues të Departamentit Teknik dhe të Departamentit të Financave, për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2022.

Më datë 12.07.2023, është mbajtur takimi në zyrat e ofruesit të shërbimeve, ku të pranishëm nga ana e ARRU-së, ishin:

Hysni Feka	Analist për tarifa
Vehbi Duraku	Analist për asete dhe investime kapitale.

Nga Ibër- Lepenci ishin:

Deme Abazi	Drejtor Teknik
Ardita Hashani	Drejtoreshe Financiare
Ernest Kërçeli	Menaxher Nj. Uji dhe Centrali
Vigan Syla	Koordinator i projektit me BB
Faton Beha	Zyrtar për politika të çmimeve

2. Investimet e aprovuara për N.H “Ibër Lepenc”

Procesi tarifor(2022-2024), bartës i të cilit është ARRU, ka një komponentë tejet të rëndësishme që janë investimet kapitale që ofruesit e shërbimeve planifikojnë t’i realizojnë gjatë periudhës tre vjeçare.

Në aplikacionin tarifor Ibër Lepenc ka dorëzuar projeksionet e investimeve kapitale për 3 vitet e procesit tarifor. Vlera e tërësishme e këtyre projekteve prej burimeve vetjake është rreth 3.58 milion €.

Tabela 1. Investimet prej burimeve vetjake të Ibër Lepenc për vitet 2022-2024

Emri i projektit	2022	2023	2024
Ndërtimi I objektit administrativ ne Shkabaj	660,000	660,000	660,000
Evakuimi I ujerave te ndotur nga penda e pridvorices	125,000	125,000	0
Mirëmbajtja dhe renovimi I kanalit kryesor dhe sekondar	280,000	220,000	0
Sanimi dhe renovimi I O.N dhe S.P	200,000	200,000	0
Mirëmbajtja e L.P 10kV dhe 35 kV	28,500	28,500	0
Sanimi I rrëshqitjes se dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi,ne Babin Most	300,000	0	0
Data center(Dhoma e serverave)	95,000	0	0
Gjithsej	1,688,500	1,233,500	660,000

Pas pranimit të aplikacionit tarifor, ARRU mbështetur në analizat rregulatore ka bërë ndërhyrje në vlerat e projekteve të investimeve kapitale prej burimeve vetjake.

Investimet e planifikuara të N.H “Ibër Lepenci” janë komplekse pasi që jo të gjitha ato që planifikohen ndërlidhen me veprimtarinë e ujit të pa-trajtuar me shumicë për KRU-të. Një pjesë e tyre merret për KRU, kurse pjesë të tjera të investimeve alokohen për aktivitetet e pa rregulluara të N.H “Ibër Lepenci”.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vetëm totali i investimeve vetjake të pranuar nga ARRU, për vitet 2022-2024, të cilat ndikojnë në tarifën e ujit me shumicë të pa trajtuar.

Tabela 2. Shuma e investimeve kapitale vetjake të aprovuara nga ARRU

Vlera e investimeve të aprovuara nga ARRU	2022	2023	2024
Totali i investimeve vetjake të pranuar nga ARRU	278,028	278,028	278,028

3. Monitorimi i listës së investimeve kapitale

Monitorimi i Listës së Investimeve Kapitale konsiston në verifikimin e projekteve të dorëzuara nga ofruesi i shërbimeve, sipas Listës, e cila si e tillë, përveç emrit të projektit ka edhe dokumentin mbështetës me përshkrim, arsyetim, para masë dhe para llogari të projektit të caktuar.

Ekipi nga ARRU ka diskutuar dhe vlerësuar implementimin e projekteve sipas Listës së investimeve me përfaqësuesit e ofruesit të shërbimeve, prej nga ka marrë informacione rreth statusit aktual për secilin projekt.

Në tabelën 3 është paraqitur ndaras lista e projekteve për shërbimeve të ujit të pa trajtuar me shumicë. Në kolonën e fundit janë komentet e ARRU-se, të marra gjatë takimit, mbi gjendjen në të cilën ndodhet secili projekt.

Tabela 3. Statusi i projekteve të aprovuara nga ARRU në vitin 2022

Emri i projektit	Planifikimet e N.H Ibër Lepenc	Statusi i projekteve
Ndërtimi i objektit administrativ ne Shkabaj	660,000	Është anuluar ky projekt për arsye të kontesteve pronësore.
Evakuimi i ujerave te ndotur nga penda e Pridvoricës	125,000	Ka përfunduar ky projekt, ujerat e zeza e asaj zone nuk lëshohet ne liqenin e Pridvoricës, por ne lumin poshtë pendës.
Mirëmbajtja dhe renovimi i kanalit kryesor dhe sekondar	280,000	Është përfunduar projekti në vlerë prej 244,027 euro.
Sanimi dhe renovimi I O.N dhe S.P	200,000	Është kontraktuar Bivolaku me TOSI Company, nuk ka pas situacione që janë paguar. Po vijohet projekti në 2023.
Mirëmbajtja e L.P 10kV dhe 35 kV	28,500	Ky projekt është permanent, është procesi i vazhdueshëm mirëmbajtja.
Sanimi i rreshqitjes se dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi,ne Babin Most	300,000	Në vitin 2023 është lidh kontrata, janë ne vazhdim të punimeve, nuk ka situacione të paguara për vitin 2022. Është kompania diamanti shpk.
Data center (Dhoma e serverave)	95,000	Është panifikuar të bëhet blerja e licencave ne vlere prej 100,000 euro. Antivirus, Office, domeni i qeverise, të rritet siguria, etj.
Gjithsej	1,688,500	

4. Projekti i Bankës botërore

Projekti përbëhet prej 3 komponentëve, pjesa kryesore është rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit edhe dy komponentë tjera që është mbikëqyrja dhe instalimi i sistemit SCADA.

Kanali kryesor

Kontraktorit Gener 2 i është ndërprerë kontrata me 5.7.2022. Projekti është ri tenderuar dhe punimet kanë filluar më dt. 9.06.2023 nga një konzorcium kosovar - slloven. Projekti i ka 18 muaj në dispozicion për t'u përfunduar deri më 31 tetor të 2024.

Sistemi SCADA

Kjo komponentë do të përmbyllet në fund të vitit 2023. Është bërë marrëveshja me PTK për të dërguar internetin në të gjitha pikat e kanalit të "Ibër –Lepenc". Qendra e kontrollit është në Shkabaj.

Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e këtij projekti bëhet nga një kompania ProIng sh.p.k e cila si e tillë ia lehtëson punën edhe N.H "Ibër-Lepenc" për mbarëvajtjen dhe kontrollin e projektit. Vlera e komponentës së projektit është rreth 300,000 euro.

Për realizimin e projektit, ofruesi i shërbimeve ka hyrë në detyrime kreditore në vlerën prej 20,000,000.00€, me afat pagese prej 25 vitesh. Anuiteti vjetor i kredisë e kap vlerën 726,000.00 €, e cila mbulohet me tarifën e ofruesit të shërbimeve. Nga kjo vlerë, KRU "Mitrovica" participon me 24,88 %, ose 180,641.00€. Ndërkaq, KRU "Prishtina" participin me 35,30% , ose 256,290.00€.

Pjesën tjetër e mbulojnë palët tjera jo rregulluese të veprimtarisë, me 39,82%, ose 289,069.00 €.

5. Konkluzione

1. Prej burimeve vetjake të financimit "Ibër- Lepenc" ka planifikuar shtatë projekte, në vlerë prej 1,688,500 € prej të cilave ka realizuar dy projekte, ndërkaq në vijim janë tri projekte, kurse projekti i parë është anuluar dhe projekti i fundit bartet për vitet e ardhshme të procesit tarifor.
2. Projektet, të cilat, për shkaqe të ndryshme, nuk janë pranuar teknikisht, sipas 'Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator', nuk mund të evidentohen në regjistrat kontabël. Kjo është arsyeja, që këto investime, të njohura si 'Investime në Vijim', nuk janë të përfshira, si të realizuara, gjë që, ul përqindjen e realizimit të investimeve kapitale nga burimet vetjake.

3. Mos realizimi i investimeve kapitale ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, ndërrimeve në menaxhmentin, si dhe pengesa të tjera .

6. Rekomandime

1. Projektet e aprovuara nga ARRU, dhe të mos realizuara nga ofruesi i shërbimeve, duhet të realizohen në vitet pasuese të procesit tarifor 2022-2024.
2. Me rastin e mos realizimit të investimeve kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifor 2025-2027, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
3. Ofruesi i shërbimeve që ta dorëzojë në ARRU listën e azhurnuar të investimeve kapitale për vitet 2023 dhe 2024 sipas rregullimeve të bëra nga ARRU në procesin tarifor 2022-2024.
4. Ofruesi i shërbimeve të jetë i vëmendshëm, që për shkaqe të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërrimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale.
5. Ofruesi i shërbimeve, që të bëjë planifikim të saktë sipas nevojave prioritare, që shpijnë kah efienca më e mirë .
6. Ofruesi i shërbimeve që të jetë më i vëmendshëm tek investimet kapitale të përbashkëta të cilat nuk ndikojnë në përmirësimin e efijencës.

*Ky raport u punua nga:
Departamenti i Tarifave të ARRU
Gusht 2023*